



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 15 mars 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit

Zyrës së Prokurorit të Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiç

Mbrojtjes së Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II i Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Trupi Gjykues”), në bazë të nenit 41(6), (10), dhe (12) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullave 56(2) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Historiku procedural në lidhje me rishikimin e rregullt të paraburgimit të Jakup Krasniqit (“z. Krasniqi”) është paraqitur gjerësisht në vendime të mëparshme.¹ Zhvillimet përkatëse që nga Rishikimi i Trembëdhjetë i Paraburgimit të z. Krasniqi më 15 janar 2024 (“Vendimi i Trembëdhjetë për Paraburgimin”)² përfshijnë si vijon.
2. Më 23 shkurt 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS-ja”) dorëzoi parashtrime lidhur me rishikimin e katërbëdhjetë të paraburgimit të z. Krasniqi (“Parashtrimet e ZPS-së”).³
3. Më 4 mars 2024, Mbrojtja e z. Krasniqi (“Mbrojtja e Krasniqit”) u përgjigj ndaj parashtrimeve të ZPS-së (“Përgjigjja”).⁴
4. Më 11 mars 2024, ZPS-ja u kundërpërgjigj ndaj Përgjigjes (“Kundërpërgjigjja”).⁵

¹ *Shih, p.sh.* F01110, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit* (“Vendimi i Gjashtë për Paraburgimin”), 18 nëntor 2022, konfidencial, para. 1-15 (versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, F01110/RED).

² F02059, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit*, 15 janar 2024.

³ F02145, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit*, 23 shkurt 2024.

⁴ F02161, Mbrojtja, *Përgjigje e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Parashtrimit të Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit* (F02145), 4 mars 2024.

⁵ F02174, Prokurorja e Specializuar, *Kundërpërgjigje e Prokurorisë ndaj Përgjigjes së Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Parashtrimit të Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit* (F02145), 11 mars 2024.

II. PARASHTRIMET

5. ZPS-ja kërkon vazhdimin e paraburgimit të z. Krasniqi.⁶ Ajo argumenton se në mungesë të ndryshimit të rrethanave që nga Vendimi i Trembëdhjetë për Paraburgimin, mbajtja në paraburgim e z. Krasniqi vazhdon të jetë e domosdoshme dhe e arsyeshme.⁷ ZPS-ja parashtrohet gjithashtu se ecuria e mëtejshme e gjykimit dhe nxjerrja e materialeve të tjera që i japin z. Krasniqi qasje në më shumë informacion lidhur me dëshmitarë të cënueshëm dhe provat kundër tij, mbështesin përfundimin se paraburgimi i tij është i domosdoshëm dhe i arsyeshëm.⁸

6. Mbrojtja e Krasniqit kërkon lirimin e menjëhershëm të z. Krasniqi, në varësi të kushteve që Trupi Gjykoës i konsideron të përshtatshme.⁹ Ajo parashtrohet se, në këtë moment, 40 muaj pas paraburgimit të tij, çfarëdo rreziqesh të mbetura të identifikuar nga Trupi Gjykoës janë të pamjaftueshme për të përligjur vazhdimin e paraburgimit.¹⁰

7. ZPS-ja kundërpërgjigjet se Përgjigjja duhet të hidhet poshtë dhe se z. Krasniqi duhet të mbesë në paraburgim.¹¹ Ajo parashtrohet se Përgjigjja përzier argumente të rrëzuara më parë me pohime faktike qartësisht të pasakta, në përpjekje për të kërkuar në mënyrë të palejueshme rishikim të çështjeve të debatuar dhe të shqyrtuar më parë.¹²

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Dispozitat ligjore të zbatueshme në kuadër të këtij vendimi përcaktohen në nenin 41(6), (10), dhe (12) dhe rregullat 56 dhe 57, dhe janë shtjelluar gjerësisht në

⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 29.

⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 6. *Shih gjithashtu* Parashtrimet e ZPS-së, para. 13-15, 19-20, 25.

⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 6.

⁹ Përgjigjja, para. 3, 15.

¹⁰ Përgjigjja, para. 3, 5, 15. *Shih gjithashtu* Përgjigjen, para. 6-14.

¹¹ Kundërpërgjigjja, para. 1, 8.

¹² Kundërpërgjigjja, para. 1.

vendime të mëparshme.¹³ Trupi Gjykses do t'i zbatojë këto standarde në këtë vendim.

IV. RISHIKIMI I RREGULLT I PARABURGIMIT

9. Qëllimi i rishikimit të paraburgimit çdo dy muaj në pritje të gjykimit sipas nenit 41(10) është që të përcaktohet nëse ende ekzistojnë arsye që përlligjin paraburgimin.¹⁴ Ndryshimi i rrethanave, ndonëse nuk është përcaktues, do të merret parasysh nëse shtrohet para trupit gjykues përkatës, ose *proprio motu*.¹⁵

A. KRITERET E NENIT 41

i. Dyshimi i bazuar

10. Sa i përket standardit për vazhdimin e paraburgimit, neni 41(6)(a) kërkon ekzistencën e dyshimit të bazuar se personi i paraburgosur ka kryer vepër penale që përfshihet në juridiksionin e Dhomave të Specializuara ("DHS"). Ky është kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimin të paraburgimit të personit të paraburgosur.¹⁶

11. ZPS-ja argumenton se, në mungesë të ndonjë ndryshimi të rrethanave që nga vendimi për konfirmimin e aktakuzës dhe Vendimit të Trembëdhjetë për Paraburgimin, vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar se z. Krasniqi ka kryer vepër penale që përfshihet në juridiksionin e DHS-së.¹⁷ Mbrojtja e Krasniqit nuk bën parashtrime konkrete për këtë pikë.

¹³ *Shih, p.sh.* Vendimin e Gjashtë për Paraburgimin, para. 18-21.

¹⁴ IA022/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit*, 22 gusht 2022, konfidencial, para. 37 (versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë), IA022/F00005/RED).

¹⁵ IA010/F00008, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit*, 27 tetor 2021, konfidencial, para. 19 (versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë), IA010/F00008/RED).

¹⁶ *Shih* ECtHR, *Merabishvili v. Georgia* [GC], no. 72508/13, [Judgment](#), 28 November 2017, para. 222.

¹⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 7 (me referenca të mëtejshme).

12. Trupi Gjykses rikujton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake përcaktoi se, në pajtim me nenin 39(2), ekzistonte dyshimi i bazuar mirë se z. Krasniqi është penalisht përgjegjës për një numër krimesh kundër njerëzimit (përndjekje, burgosje, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje e paligjshme dhe zhdukje me forcë) dhe krime lufte (ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme) sipas neneve 13, 14(1)(c) dhe 16(1)(a).¹⁸ Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se është vërtetuar dyshimi i bazuar mirë edhe në lidhje me akuzat e reja të ngritura nga ZPS-ja kundër z. Krasniqi.¹⁹ Këto konstatime

¹⁸ F00026, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 521(a)(i)-(ii). Versioni i redaktuar konfidencial (F00026/CONF/RED), versioni i redaktuar publik (F00026/RED), dhe versioni konfidencial me më pak redaktime (F00026/CONF/RED2) u dorëzuan, përkatësisht, më 19 nëntor 2020, 30 nëntor 2020, dhe 21 shtator 2023. ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e konfirmuar si F00034, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar dhe Kërkesave lidhur me Të*, 30 tetor 2020, konfidencial, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcat 2-3, konfidenciale; F00045/A03, Prokurori i Specializuar, *Aktakuza e Redaktuar më Tej*, 4 nëntor 2020; F00134, Prokurori i Specializuar, *Version me më pak Redaktime i Aktakuzës së Redaktuar*, KSC-BC-2020-06/F00045/A02, 4 nëntor 2020, 11 dhjetor 2020, konfidencial. Aktakuza e konfirmuar e korrigjuar më tej u dorëzua më 3 shtator 2021, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (F00455/A01), me versionin e redaktuar konfidencial (F00455/CONF/RED/A01) dhe versionin e redaktuar publik (F00455/RED/A01). Më 17 janar 2022, ZPS-ja dorëzoi versionin konfidencial, të korrigjuar dhe me më pak redaktime të aktakuzës së konfirmuar, F00647/A01.

¹⁹ F00777, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Ndryshimeve në Aktakuzë*, 22 prill 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 183. Versioni i redaktuar konfidencial (F00777/CONF/RED), versioni i redaktuar publik (F00777/RED), versioni konfidencial me më pak redaktime (F00777/CONF/RED2), dhe versioni konfidencial edhe me më pak redaktime (F00777/CONF/RED3) u protokolluan, përkatësisht, më 22 prill 2022, 6 maj 2022, 16 maj 2022, dhe 21 shtator 2023. Ndryshimet e kërkuara jepen në hollësi në para. 11. Aktakuza e konfirmuar e ndryshuar u dorëzua nga ZPS-ja më 29 prill 2022, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (F00789/A01), me versionin e redaktuar konfidencial (F00789/A02) dhe versionin e redaktuar publik (F00789/A05). Më 30 shtator 2022, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar më tej ("Aktakuza e Konfirmuar"), rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (F00999/A01; riklasifikuar si konfidenciale dhe statusi *ex parte* u hoq më 26 janar 2023), me versionin e redaktuar konfidencial (F00999/A02) dhe versionin e redaktuar publik (F00999/A03; versioni publik me më pak redaktime [F01296/A03] dhe versioni publik edhe me më shumë redaktime [F01323/A01] u dorëzuan, përkatësisht, më 15 shkurt 2023 dhe 27 shkurt 2023), sipas urdhrit Gjykatësi i Procedurës Paraprake (F00895, *Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Vendim mbi Mocionin për Mangësi në Formën e Aktakuzës së Ndryshuar*, 22 korrik 2022, para. 49(e); F00993, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshimin e Aktakuzës*, 29 shtator 2022, konfidencial, para. 24(b); versioni i redaktuar publik u dorëzua në të njëjtën ditë, F00993/RED).

u bënë mbi bazën e një standardi edhe më të lartë se ai i dyshimit të bazuar që kërkohet sipas nenit 41(6)(a).²⁰

13. Në mungesë të ndonjë rrethane të re materiale që do të ndikonte në konstatimet e mësipërme, Trupi Gjykses arrin në përfundimin se vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar se z. Krasniqi ka kryer vepra penale që përfshihen në juridiksionin lëndor të DHS-së, sipas nenit 41(6)(a) dhe (10).

ii. Domosdoshmëria e paraburgimit

14. Në lidhje me arsyet për vazhdimin e paraburgimit, neni 41(6)(b) përcakton tri arsye (rreziqe) alternative në bazë të të cilave mund të konstatohet se paraburgimi është i domosdoshëm: (i) rreziku i arratisjes; (ii) rreziku i pengimit të procesit; ose (iii) rreziku i kryerjes së veprave penale të tjera.²¹ Paraburgimi vazhdohet nëse ka arsye të artikulueshme për të besuar se një ose më shumë prej këtyre rreziqeve do të materializohen.²² Termi “të artikulueshme” në këtë kontekst përdoret në kuptimin që arsyet duhet të specifikohen me hollësi, duke iu referuar informacionit ose provave relevante.²³ Në përcaktimin nëse ekziston ndonjë prej arsyeve të përcaktuara në nenin 41(6)(b) për paraburgimin e një personi, standardi i zbatueshëm është më i ulët se pashmangshmëria, por më i lartë se thjesht mundësia që ndonjë prej rreziqeve të materializohet²⁴

²⁰ *Shih p.sh.* IA008/F00004, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit*, 1 tetor 2021, konfidencial, para. 21 (versioni i redaktuar konfidencial u lëshua më të njëjtën ditë, IA008/F00004/RED).

²¹ *Krahaso* ECtHR, *Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC], no. 23755/07, [Judgment](#), 5 July 2016, para. 88; ECtHR, *Zohlandt v. the Netherlands*, no. 69491/16, [Judgment](#), 9 February 2021, para. 50; ECtHR, *Grubnyk v. Ukraine*, no. 58444/15, [Judgment](#), 17 September 2020, para. 115; ECtHR, *Korban v. Ukraine*, no. 26744/16, [Judgment](#), 4 July 2019, para. 155.

²² IA004/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm* (“Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Thaçit”), 30 prill 2021, konfidencial, para. 19 (versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, IA004/F00005/RED).

²³ Neni 19.1.31 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës 2022, Ligji nr. 08/L-032 përkufizon “të artikulueshme” si: “pala e cila paraqet informacionin apo provën duhet të specifikojë informatën apo provën në të cilën mbështetet”.

²⁴ Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Thaçit, para. 22.

a) Rreziku i arratisjes

15. ZPS-ja parashtron se njohuritë më të mëdha të z. Krasniqi për kuadrin e çështjes, përfshirë për akuzat kundër tij dhe provat që do të paraqiten në lidhje me këto akuza, shton rrezikun që ai të arratiset.²⁵ Ajo argumenton se kjo, e kombinuar me konstatimet e mëparshme lidhur me mjetet e z. Krasniqi për të udhëtuar dhe mundësinë e re për shtetasit e Kosovës që të udhëtojnë pa vizë në Bashkimin Evropian ("BE"), e bëjnë mjaftueshmërisht real rrezikun që z. Krasniqi të arratiset.²⁶ Mbrojtja e Krasniqit nuk bën parashtrime konkrete për këtë pikë.

16. Pasi i shqyrtoi argumentet e ZPS-së duke pasur parasysh fazën aktuale të procesit, Trupi Gjykses vlerëson se, në këtë aspekt nuk ka faktorë të rinj relevantë në lidhje me këtë aspekt. Argumenti i ZPS-së për mjetet e udhëtimit të z. Krasniqi nuk është i ri.²⁷ Edhe nëse merret parasysh bashkë me parashtrimet e reja lidhur me mundësinë e shtetasve të Kosovës për të udhëtuar në BE pa vizë, kjo nuk ndikon në konstatimin e mëparshëm të Trupit Gjykses se rreziku i arratisjes për z. Krasniqi nuk është vërtetuar. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses rithekson se konstatimin e vet të mëparshëm se ZPS-ja nuk ka vërtetuar pretendimin se ekziston një "mundësi mjaftueshmërisht reale"²⁸ që i akuzuari të arratiset në qoftë se lirohet.²⁹

²⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 9.

²⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 9.

²⁷ *Shih p.sh.* F01188, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit*, 6 janar 2023, konfidencial, para. 16, 31 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 16 janar 2023, F01188/RED).

²⁸ *Shih p.sh.* Vendimin e Parë të Apelit mbi Paraburgimin e Thaçit, para. 24.

²⁹ *Shih* Vendimin e Trembëdhjetë për Paraburgimin para. 17.

17. Gjithashtu, sikurse është përcaktuar tashmë, ka prova që tregojnë se z. Krasniqi ka bashkëpunuar në çdo aspekt me autoritetet përkatëse gjatë paraburgimit dhe transferimit e tij.³⁰

18. Ndonëse rreziku i arratisjes nuk mund të përjashtohet plotësisht asnjëherë, Trupi Gjykses gjykon se vazhdimi i paraburgimit të z. Krasniqi aktualisht nuk mund të përlijet mbi bazën e rrezikut të arratisjes sipas nenit 41(6)(b)(i).

b) Rreziku i pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së

19. Duke iu referuar konstatimeve të mëparshme të këtij Trupi Gjykses, ZPS-ja parashtron se z. Krasniqi vazhdon të përbëjë rrezik për pengimin e procesit.³¹ Sipas ZPS-së, nxjerrja e mëtejshme e informacionit tejet të ndjeshëm për Mbrojtjen e Krasniqit dhe për z. Krasniqi vazhdon të shtojë rrezikun që informacion i ndjeshëm në lidhje me dëshmitarët të bëhet i njohur për publikun përpara se dëshmitarët në fjalë të japin dëshmi.³² Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se vazhdon të ekzistojë atmosfera e frikësimit të dëshmitarëve dhe e ndërhyrjeve ndaj tyre, e cila, siç është konstatuar nga Gjykata e Apelit, është një faktor kontekstual relevant.³³

20. Mbrojtja e Krasniqit argumenton se nuk ekziston mundësi mjaftueshmërisht reale që z. Krasniqi të pengojë procesin.³⁴ Në veçanti, ajo parashtron se nuk ka tregues ose prova (të mjaftueshme) për: (i) lidhje midis z. Krasniqi dhe orvatjeve të pretenduara për të frikësuar dëshmitarët ose, më përgjithësisht, atmosferës së pretenduar të frikësimit të dëshmitarëve; ose (ii) orvatje të z. Krasniqi për të penguar procesin në ndonjë mënyrë, apo për sjellje të tjera të palejueshme nga ana

³⁰ F01212, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit* ("Vendimi i Shtatë për Paraburgimin"), 17 janar 2023, konfidencial, para. 18 dhe poshtëshënimi 30 (versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, F01212/RED).

³¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 10-15 (*që citon, në veçanti, Vendimin e Trembëdhjetë për Paraburgimin*, para. 24-26).

³² Parashtrimet e ZPS-së, para. 13-15.

³³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 12 (me referenca të mëtejshme).

³⁴ Përgjigja, para. 2, 6-10

e tij.³⁵ Gjithashtu, Mbrojtja e Krasniqit parashton se asnjë nga dëshmitarët e ZPS-së që kanë dëshmuar deri tani nuk ka dhënë dëshmi të besueshme që të jetë tejet kritike për sjelljen personale të z. Krasniqi.³⁶ Më tej, Mbrojtja e Krasniqit parashton se rreziku i ndërhyrjes zvogëlohet pashmangshmërisht me ecurinë e procesit sepse: (i) dëshmitarët që kanë dëshmuar deri më tani duhet të kenë qenë ndër më të cenueshmit; dhe (ii) duke qenë se kanë dëshmuar, ata nuk janë më të cenueshëm ndaj ndërhyrjeve.³⁷

21. Në kundërpërgjigje, ZPS-ja kundërshton argumentet e Mbrojtjes së Krasniqit lidhur me mungesën së provave për sjellje të palejueshme të z. Krasniqi, sa i përket dhënies dhe përdorimit të palejueshëm të informacionit konfidencial.³⁸ Ajo parashton se, duke qenë se z. Krasniqi nuk ishte objekt i hetimeve të kryera në objektin e paraburgimit të DHS-së (“objekti i paraburgimit”), fakti është thjesht që provat në lidhje me z. Krasniqi nuk ishin të disponueshme dhe nuk u paraqitën dhe jo që këto hetime kanë treguar diçka pozitive për të.³⁹ ZPS-ja u referohet gjithashtu konstatimeve të mëparshme të Trupit Gjykses për: (i) standardin e përdorur për vlerësimin e rreziqeve sipas nenit 41(6)(b), i cili nuk kërkon “shembull konkret” të sjelljes së palejueshme; dhe (ii) atmosferën e përgjithshme e ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve.⁴⁰ Gjithashtu, ZPS-ja kundërshton pretendimin e Mbrojtjes së Krasniqit se rreziku i ndërhyrjes zvogëlohet pashmangshmërisht me ecurinë e procesit gjyqësor, apo se dëshmitarët që kanë dëshmuar nuk janë më të cenueshëm nga ndërhyrjet.⁴¹ ZPS-ja parashton se vazhdimisht ka theksuar se në përcaktimin e rendit të hershëm të paraqitjes së dëshmitarëve, është bazuar kryesisht në rëndësinë e dëshmisë së dëshmitarit për çështjen dhe në rrezikun e

³⁵ Përgjigja, para. 2, 6-10.

³⁶ Përgjigja, para. 2. *Shih edhe* Përgjigjen, para. 8.

³⁷ Përgjigja, para. 10.

³⁸ Kundërpërgjigja, para. 2-4.

³⁹ Kundërpërgjigja, para. 2.

⁴⁰ Kundërpërgjigja, para. 3, *që i referohet në veçanti*, Vendimit të Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 23.

⁴¹ Kundërpërgjigja, para. 5.

ndërhyrjes ndaj dëshmitarit, dhe se jo të gjithë dëshmitarët në rrezik ndërhyrjeje mund të thirreshin herët.⁴²

22. Trupi Gjykues thekson standardin e përdorur për vlerësimin e rreziqeve sipas nenit 41(6)(b), ku nuk kërkohet “shembull konkret” i një situate në të cilën z. Krasniqi ka frikësuar ose ngacmuar personalisht ndonjë dëshmitar.⁴³ Rrjedhimisht, sikurse është thënë më parë, fakti që ZPS-ja nuk ka dorëzuar asnjë provë që sugjeron se z. Krasniqi u dha në mënyrë të palejueshme informacion konfidencial vizitorëve, se tentoi të ndërhynte tek dëshmitarët, apo se u soll në mënyrë të papërshtatshme në objektin e paraburgimit,⁴⁴ nuk do të thotë se nuk mund të ekzistojë rrezik sipas nenit 41(6)(b).⁴⁵ Më e rëndësishme, kjo nuk bie ndesh me konstatimin e mëparshëm të Trupit Gjykues se kjo çështje po gjykohet në kontekstin e informacionit se në Kosovë ekziston një atmosferë e përgjithshme e ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve në lidhje me këtë dhe me çështje gjyqësore të tjera në Dhomat e Specializuara.⁴⁶

23. Trupi Gjykues ka konstatuar më parë dhe përsërit se ekziston rreziku që z. Krasniqi të pengojë procedurat e DHS-së bazuar, ndër të tjera: (i) në pozitën e tij

⁴² Kundërpërgjigjja, para. 5.

⁴³ *Shih* Vendimin e Shtatë për Paraburgimin, para. 23, që i referohet IA003/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit për Lirim të Përkohshëm* (“Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Selimit”), 30 prill 2021, konfidencial, para. 59 (versioni i redaktuar publik u lëshua në të njëjtën ditë, IA003/F00005/RED).

⁴⁴ *Shih* F01977, Trupi Gjykues, *Vendim i Mëtejshëm mbi Kërkesën Urgjente të Prokurorisë për Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit për Hashim Thaçin, Kadri Veselin dhe Rexhep Selimin* (“Vendimi i 1 Dhjetorit 2023”), 1 dhjetor 2023, para. 29.

⁴⁵ Vendimi Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 23.

⁴⁶ *Shih* F01679, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit* (“Vendimi i Dhjetë për Paraburgimin”), 17 korrik 2023, konfidencial, para. 27 (versioni i redaktuar publik u lëshua më 9 gusht 2023, F01679/RED); F01530, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit* (“Vendimi i Nëntë për Paraburgimin”), 17 maj 2023, konfidencial, para. 23 (versioni i redaktuar publik u lëshua më 22 maj 2023, F01530/RED); F01382, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit* (“Vendimi i Tetë për Paraburgimin”), 17 mars 2023, konfidencial, para. 26 (versioni i redaktuar publik u lëshua më 20 mars 2023, F01382/RED), që i referohet KSC-BC-2020-05, F00494/RED/COR, Trupi Gjykues I, *Versioni i Korrigjuar i Versionit të Redaktuar Publik të Aktgjykimit*, 24 janar 2023, para. 57. *Shih gjithashtu* F01926, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit* (“Vendimi i Dymbëdhjetë për Paraburgimin”), 15 nëntor 2023, para. 26; Vendimi i Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 23.

me ndikim e cila, së bashku me gatishmërinë dhe aftësinë për të siguruar informacion konfidencial jopublik, të çon në përfundimin e arsyeshëm se është e mundshme që z. Krasniqi të sigurojë qasje në informacion për aspekte të cilat aktualisht kanë lidhje me të; (ii) deklaratat e tij publike në të cilat kritikohet DHS-ja; dhe (iii) përmbajtjen e postimit të tij të datës 24 prill 2020 në Facebook ku vë në shënjestër “bashkëpunëtorët”.⁴⁷ Gjithashtu, Gjykata e Apelit ka konfirmuar se: (i) ka tregues se z. Krasniqi, më së paku, ka predispozitën për të frikësuar dëshmitarët, për arsyet e lartpërmendura;⁴⁸ dhe (ii) gjatë vlerësimit nëse ekziston rreziku që z. Krasniqi të pengojë procedurat në rast se lirohet, nuk ishte e paarsyeshme që të merreshin parasysh, ndër faktorë të tjerë, deklaratat e tij publike kritike ndaj DHS-së ose e postimi i datës 20 prill 2020 në Facebook.⁴⁹

24. Siç është vënë në dukje më parë, duke qenë se gjykimi vazhdon, emrat dhe të dhënat personale të disa dëshmitarëve tejet të cenueshëm janë nxjerrë dhe do të vijojnë të nxirren për Mbrojtjen e Krasniqit,⁵⁰ dhe rrjedhimisht, do t’u bëhen të njohur një numri më të madh personash, përfshirë z. Krasniqi. Trupi Gjykues rikonfirmon se kjo, nga ana e saj, shton rrezikun që informacioni i ndjeshëm në lidhje me dëshmitarë t’i bëhet i njohur publikut përpara se këta dëshmitarë të japin

⁴⁷ *Shih p.sh.* F00801, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit* (“Vendimi i Katërt për Paraburgimin”), 13 maj 2022, konfidencial dhe *ex parte*, para. 48 (versioni i redaktuar konfidencial, F00801/CONF/RED, dhe versioni i redaktuar publik, F00801/RED, u lëshuan përkatësisht më 13 dhe 24 maj 2022).

⁴⁸ IA002/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit në lidhje me Lirimin e Përkohshëm* (“Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit”), 30 prill 2021, konfidencial, para. 62 (versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, IA002/F00005/RED); IA006/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Jakup Krasniqit ndaj Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit*, 1 tetor 2021, konfidencial, para. 30 (versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, IA006/F00005/RED).

⁴⁹ Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit, para. 50.

⁵⁰ *Shih* Vendimin e Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 25; Vendimin e Dymbëdhjetë për Paraburgimin, para. 25; F01795, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit* (“Vendimi i Njëmbëdhjetë për Paraburgimin”), 15 shtator 2023, konfidencial, para. 20 (versioni i redaktuar publik u lëshua në të njëjtën ditë, F01795/RED); Vendimi i Dhjetë për Paraburgimin, para. 26; Vendimi i Nëntë për Paraburgimin, para. 22; Vendimi i Tetë për Paraburgimin, para. 25.

dëshmi.⁵¹ Në këtë kontekst, lirimi i një të akuzuari në dijeni të informacionit të ndjeshëm nuk do të ndihmonte mbrojtjen efikase të dëshmitarëve që ende nuk kanë dhënë dëshmi.⁵²

25. Lidhur me argumentin e Mbrojtjes së Krasniqit se rreziku i ndërhyrjes zvogëlohet pashmangshmërisht me vijimin e gjykimit,⁵³ ky parashtrim i përgjithshëm nuk është medoemos i vërtetë. Së pari, ka dëshmitarë të mbrojtur tejet të ndjeshëm që nuk kanë dëshmuar ende. Gjithashtu, dëshmitarët që kanë dhënë dëshmi mund të jenë ende në rrezik ndërhyrjeje, p.sh në rast se orvatjet për ndërhyrje synojnë tërheqjen e dëshmisë dhe/ose të bindin në mënyrë të tërthortë dëshmitarët e ardhshëm që të mos dëshmojnë,⁵⁴ që mund të pengojë ecurinë e procesit gjyqësor në kuptimin e nenit 41(6)(b)(ii). Gjithashtu, mund të ndodhë që dëshmitarët të thirren përsëri, kjo i bën ata të cenueshëm ndaj orvatjeve për ndërhyrje dhe mund të çojë gjithashtu në pengim të ecurisë së gjykimit.

26. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses arrin në përfundimin se, duke marrë parasysh të gjithë faktorët së bashku, vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Krasniqi të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së në qoftë se lirohet.

a) Rreziku i kryerjes së veprave penale të tjera

27. Lidhur me konstatimet e Trupit Gjykses në Vendimin e Trembëdhjetë mbi Paraburgimin, ZPS-ja parashtron se z. Krasniqi vazhdon të paraqesë rrezik për kryerjen e veprave penale të tjera.⁵⁵ Sipas ZPS-së, përfundimi i Trupit Gjykses se nxjerrja e vazhdueshme e informacionit të ndjeshëm përbënte rrezik të

⁵¹ Vendimi i Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 25.

⁵² *Shih* Vendimin e Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 25; Vendimin e Dymbëdhjetë për Paraburgimin, para. 25; Vendimin e Njëmbëdhjetë për Paraburgimin, para. 20; Vendimin e Dhjetë për Paraburgimin, para. 26; Vendimin e Nëntë për Paraburgimin, para. 22; Vendimin e Tetë për Paraburgimin, para. 25; Vendimin e Shtatë për Paraburgimin, para. 25.

⁵³ Përgjigjja, para. 10.

⁵⁴ *Shih edhe* Kundërpërgjigjen, para. 5.

⁵⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 16-20 (*duke cituar, në veçanti, Vendimin e Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 30-32*).

papranueshëm të kryerjes së veprave penale të tjera, merr edhe më shumë rëndësi duke marrë parasysh ecurinë e gjykimit.⁵⁶ Gjithashtu, ZPS-ja argumenton se duhen marrë parasysh edhe se sa të rënda janë akuzat kundër z. Krasniqi.⁵⁷

28. Mbrojtja e Krasniqit parashtrohet se nuk ka prova që vërtetojnë praninë e një rreziku mjaftueshmërisht real që z. Krasniqi do të kryejë vepra penale të tjera.⁵⁸ Në veçanti, ajo parashtrohet se z. Krasniqi ka treguar sjellje shembullore në paraburgim, që është tregues i fortë se, në qoftë se lirimi i përkohshëm miratohet, ai do të vazhdojë në këtë mënyrë.⁵⁹

29. ZPS-ja kundërpërgjigjet se mbështetja e Mbrojtjes së Krasniqit në faktin se ai nuk ka kryer vepra të tjera penale që nga vendimi i parë për paraburgimin e tij, keqkupton thelbësisht qëllimin e paraburgimit, që është pikërisht zvogëlimi i rrezikut të kryerjes së veprave penale të tjera.⁶⁰ Ajo argumenton se mungesa e provave të mëtijshme në lidhje me rreziqet sipas nenit 41(6) nuk zhvlerëson mjaftueshmërinë e provave që i vërtetuan ato rreziqe në vendimet e mëparshme mbi paraburgimin.⁶¹

30. Trupi Gjykses rikujton konstatimin e vet në Vendimin e Trembëdhjetë mbi Paraburgimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Krasniqi të kryejë vepra penale të tjera.⁶² Trupi Gjykses konstaton se të njëjtët faktorë dhe vlerësime që u morën parasysh në lidhje me rrezikun e pengimit vlejné dhe për shqyrtimin e rrezikut të kryerjes së veprave penale të tjera nga z. Krasniqi.⁶³ Bazuar në këta faktorë, dhe pavarësisht parashtrimeve të Mbrojtjes së Krasniqit në këtë aspekt,⁶⁴ Trupi

⁵⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 20.

⁵⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 18.

⁵⁸ Përgjigjja, para. 2, 11-12.

⁵⁹ Përgjigjja, para. 12.

⁶⁰ Kundërpërgjigjja, para. 6.

⁶¹ Kundërpërgjigjja, para. 6.

⁶² Vendimi i Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 32.

⁶³ *Shih më lart*, para. 22-25. *Shih gjithashtu* Vendimin e Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 30.

⁶⁴ Përgjigjja, para. 11-12.

Gjykues konstaton se, që nga rishikimi i fundit i paraburgimit, nuk ka dalë asnjë rrethanë e re që do të përligjte konstatim të ndryshëm mbi këtë pikë.

31. Gjithashtu, Trupi Gjykues thekson faktin se gjykimi i kësaj çështje vijon dhe se duhet të shmanget çdo rrezik i kryerjes së veprave penale të tjera.⁶⁵

32. Trupi Gjykues gjykon, duke marrë parasysh të gjithë faktorët së bashku, se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Krasniqi do të kryejë vepra penale të tjera sipas nenit 41(6)(b)(iii).

iii. Përfundim

33. Trupi Gjykues arrin në përfundimin se aktualisht ai ende nuk ka informacion të mjaftueshëm që do të përligjte konstatimin se z. Krasniqi mund t'i ikë drejtësisë. Megjithatë Trupi Gjykues është bindur, në bazë të standardit përkatës, se ekziston rreziku që z. Krasniqi do të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së dhe do të kryejë vepra penale të tjera kundër atyre që konsiderohen se janë kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ku përfshihen dëshmitarët që kanë dhënë ose mund të japin dëshmi në këtë çështje gjyqësore dhe/ose pritet të paraqiten para DHS-së. Trupi Gjykues do të vlerësojë në vijim nëse kushtet për lirimin e z. Krasniqi mund të trajtojnë në mënyrën e duhur këto rreziqe.

B. MASAT ALTERNATIVE NDAJ PARABURGIMIT

34. ZPS-ja iu referohet konstatimeve të mëparshme të Trupit Gjykues dhe parashtron se: (i) rreziqet nga neni 41(6)(b) mund të trajtohen në mënyrë efektive vetëm në objektin e paraburgimit të DHS-së; (ii) që nga Vendimi i Trembëdhjetë mbi Paraburgimin nuk ka ndryshuar asgjë që do të përligjte një vlerësim të ndryshëm të kushteve, në përgjithësi apo për një periudhë të caktuar kohore; dhe

⁶⁵ Shih gjithashtu Vendimin e Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 31.

(iii) përkundrazi, vazhdimi i gjykimit dhe nxjerrja e mëtejshme e materialeve gjatë tij, i shtojnë këto rreziqe më shumë se kurrë.⁶⁶

35. Mbrojtja e Krasniqit e lë në dorë të Trupit Gjykses të vendosë në lidhje me kushtet që i konsideron të përshtatshme.⁶⁷

36. Në marrjen e vendimit nëse një person duhet të lirohet apo të mbahet në paraburgim, Trupi Gjykses duhet të marrë parasysh masa alternative për të shmangur rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b).⁶⁸ Në nenin 41(12) përcaktohen një numër opsionesh që duhet të merren parasysh për të garantuar praninë e të akuzuarit në gjykim, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale apo për të garantuar kryerjen me sukses të procesit penal. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses rikujton se paraburgimi duhet të vazhdohet vetëm nëse nuk ekzistojnë masa alternative më të buta dhe të disponueshme në mënyrë të arsyeshme, të cilat do të zvogëlonin mjaftueshëm rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b).⁶⁹ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses duhet të shqyrtojë të gjitha masat alternative të arsyeshme që mund të vendosen dhe jo vetëm ato që parashtrojnë Mbrojtja e Krasniqit apo ZPS-ja.⁷⁰

37. Sa i përket rrezikut të pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së dhe të kryerjes së veprave penale të tjera, Trupi Gjykses ka konstatuar në mënyrë të përsëritur se:

⁶⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 21-25 (*që i referohen* Vendimit e Trembëdhjetë për Paraburgimin, para, para. 37-39).

⁶⁷ Përgjigja, para. 3, 15.

⁶⁸ Në lidhje me detyrimin për të shqyrtuar "masa alternative", shih KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave Miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas Nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar* ("Aktvendimi i DHSGJK-së i datës 26 prill 2017"), 26 prill 2017, para. 114. Shih gjithashtu, ECtHR, *Buzadji v. the Republic of Moldova*, para. 87 *in fine*; ECtHR, *Idalov v. Russia* [GC], no. 5826/03, *Judgment*, 22 May 2012, para. 140 *in fine*.

⁶⁹ Aktvendimi i DHSGJK-së i datës 26 prill 2017, para. 114; KSC-CC-PR-2020-09, F00006, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Miratuara nga Plenarja më 29 dhe 30 prill 2020*, 22 maj 2020, para. 70. Shih gjithashtu ECtHR, *Idalov v. Russia* [GC], para. 140 *in fine*.

⁷⁰ Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Selimit, para. 86; KSC-BC-2020-05, F00127, Trupi Gjykses I, *Vendimi i Katërt mbi Rishikimin e Paraburgimit*, 25 maj 2021, para. 24.

- a) Asnjë prej kushteve të propozuara më herët nga Mbrojtja e Krasniqit dhe as ndonjë masë shtesë sipas nenit 41(12), e urdhëruar *proprio motu*, nuk mund të zvogëlojë mjaftueshëm rreziqet ekzistuese në këtë fazë të procesit sa i përket z. Krasniqi;⁷¹
- b) Masat në fuqi në objektin e paraburgimit, marrë në tërësi: (i) ofrojnë garanci të forta kundrejt vizitave dhe komunikimeve të pamonitoruara me anëtarët e familjes dhe vizitorët e miratuar paraprakisht me synimin për të zvogëluar rrezikun e pengimit të procesit dhe të kryerjes së veprave penale të tjera; dhe (ii) ofrojnë mjedis të kontrolluar ku shkelja e mundshme e konfidencialitetit mund të evidentohet dhe/ose parandalohet më lehtë;⁷² dhe
- c) Komunikimet e z. Krasniqi mund të kufizohen në një mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm rreziqet e pengimit të procesit dhe të kryerjes së veprave penale të tjera vetëm përmes kornizës për monitorimin e komunikimeve që zbatohet në objektin e paraburgimit të DHS-së.⁷³

38. Trupi Gjykues rikonfirmon se, në këtë fazë të procesit, asnjë masë shtesë sipas nenit 41(12), e urdhëruar *proprio motu*, nuk do të mund të zvogëlojë rreziqet ekzistuese në lidhje me z. Krasniqi në mënyrë të mjaftueshme dhe në masë të krahasueshme me paraburgimin në objektin e paraburgimit.

⁷¹ Shih Vendimin e Trembëdhjetë për Paraburgimin para. 37; Vendimin e Dymbëdhjetë për Paraburgimin, para. 39; Vendimin e Njëmbëdhjetë për Paraburgimin, para. 29; Vendimin e Dhjetë për Paraburgimin, para. 41; Vendimin e Nëntë për Paraburgimin, para. 33; Vendimin e Tetë për Paraburgimin, para. 37; Vendimin e Shtatë për Paraburgimin, para. 38. Shih gjithashtu IA020/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit*, 2 gusht 2022, konfidencial, para. 39 (versioni i redaktuar publik është lëshuar në të njëjtën ditë, IA020/F00005/RED).

⁷² Shih Vendimin e Trembëdhjetë për Paraburgimin para. 37; Vendimin e Dymbëdhjetë për Paraburgimin, para. 39; Vendimin e Njëmbëdhjetë për Paraburgimin, para. 29; Vendimin e Dhjetë për Paraburgimin, para. 41; Vendimin e Nëntë për Paraburgimin, para. 33; Vendimin e Tetë për Paraburgimin, para. 37; Vendimin e Shtatë për Paraburgimin, para. 38. Shih gjithashtu IA016/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit në lidhje me Rishikimin e Vendimit të Kthyer mbi Paraburgimin dhe për Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit*, 25 mars 2022, konfidencial, para. 30 (versioni i redaktuar publik është lëshuar në të njëjtën ditë, IA016/F00005/RED).

⁷³ Shih Vendimin e Trembëdhjetë për Paraburgimin para. 37; Vendimin e Dymbëdhjetë për Paraburgimin, para. 39; Vendimin e Njëmbëdhjetë për Paraburgimin, para. 29; Vendimin e Dhjetë për Paraburgimin, para. 41; Vendimin e Nëntë për Paraburgimin, para. 34; Vendimin e Tetë për Paraburgimin, para. 38; Vendimin e Shtatë për Paraburgimin, para. 39.

39. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses mbetet i bindur për konstatimet e veta të mëparshme, të përmbledhura në paragrafin 37 më lart, dhe konstaton se rreziqet e pengimit të procesit dhe kryerjes së veprave penale të tjera mund të trajtohen në mënyrë efektive në këtë fazë vetëm në qoftë se z. Krasniqi vazhdon të mbahet në objektin e paraburgimit. Në këto rrethana, Trupi Gjykses konstaton se nuk ka masa alternative ndaj vazhdimit të paraburgimit të z. Krasniqi që do të shmangnin si duhet rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b)(ii) dhe (iii), qoftë në përgjithësi apo për një periudhë të caktuar kohore.

C. ARSYESHMËRIA E PARABURGIMIT

40. ZPS-ja argumenton se, kur merren parasysh të gjithë faktorët, paraburgimi i z. Krasniqi vazhdon të jetë proporcional.⁷⁴ Për këtë qëllim, ZPS-ja i referohet konstatimit të mëparshëm të Trupit Gjykses se: (i) kundër z. Krasniqi janë ngritur dhjetë akuza për krime të rënda ndërkombëtare në të cilat pretendohet se ai ka luajtur rol të rëndësishëm; (ii) në qoftë se shpallet fajtor, z. Krasniqi mund të dënohet me burgim të gjatë; (iii) vazhdojnë të ekzistojnë rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b)(ii) dhe (iii), që nuk mund të zvogëlohen mjaftueshëm me anë të zbatimit të masave alternative të arsyeshme; (iv) çështja kundër z. Krasniqi është komplekse; (v) ekziston atmosfera e frikësimit të dëshmitarëve e përshkruar më lart; dhe (vi) gjykimi vazhdon.⁷⁵

41. Mbrojtja e Krasniqit argumenton se vazhdimi i paraburgimit të z. Krasniqi është joproporcional.⁷⁶ Ajo parashtron, konkretisht, se qëndrimi 40 muaj në paraburgim është periudhë kohore e konsiderueshme për një person që nuk është shpallur fajtor për asnjë krim.⁷⁷ Gjithashtu, ajo parashtron se modifikimi i kohëve të fundit i kushteve në objektin e paraburgimit ka pasur pasoja të konsiderueshme

⁷⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 26-28.

⁷⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 27.

⁷⁶ Përgjigja, para. 13-14. *Shih gjithashtu* Përgjigjen, para. 15.

⁷⁷ Përgjigja, para. 13.

mbi të drejtat e z. Krasniqi dhe vizitat e tij familjare, që, rrjedhimisht, ndikon në mirëqenien e dhe të drejtën e tij për jetë familjare.⁷⁸

42. Në kundërpërgjigjen e saj, ZPS-ja u referohet konstatimeve përkatëse të Trupit Gjykses në Vendimin e Trembëdhjetë mbi Paraburgimin.⁷⁹

43. Trupi Gjykses i referohet parashtrimit të Mbrojtjes së Krasniqit se duhet të merret parasysh 'joproporcinaliteti në rritje' i periudhës në paraburgim të z. Krasniqi.⁸⁰ Siç është thënë vazhdimisht, Trupi Gjykses është i vetëdijshëm për detyrën e tij për vlerësimin e arsyeshmërisë së vazhdimin të paraburgimit të të akuzuarve, përfshirë të z. Krasniqi, bazuar në faktet e secilës çështje në përputhje me karakteristikat e veçanta të saj në momentin kur bëhet ky vlerësim.⁸¹ Gjithashtu, Trupi Gjykses është i vetëdijshëm se kohëzgjatja e paraburgimit është faktor që duhet marrë parasysh, së bashku me shkallën e rreziqeve të përshkruara në nenin 41(6)(b), për të vlerësuar nëse, kur merren parasysh të gjithë faktorët, vazhdimi i paraburgimit "pushon së qeni i arsyeshëm" dhe personi duhet të lirohet.⁸²

44. Sipas vlerësimit të Trupit Gjykses, karakteristikat e veçanta në këtë çështje përfshijnë si në vijim: (i) kundër z. Krasniqi janë ngritur dhjetë akuza për krime të rënda ndërkombëtare në të cilat pretendohet se ai ka luajtur rol të rëndësishëm;⁸³ (ii) në qoftë se shpallet fajtor, z. Krasniqi mund të dënohet me burgim të gjatë; (iii) vazhdojnë të ekzistojnë rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b)(ii) dhe (iii) dhe ato nuk mund të zvogëlohen mjaftueshëm duke zbatuar masa alternative të arsyeshme;⁸⁴

⁷⁸ Përgjigja, para. 14.

⁷⁹ Kundërpërgjigja, para. 7, që i referohet Vendimit të Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 46.

⁸⁰ Përgjigja, para. 13.

⁸¹ Vendimi i Trembëdhjetë për Paraburgimin para. 43; Vendimi i Dymbëdhjetë për Paraburgimin, para. 45; Vendimi i Njëmbëdhjetë për Paraburgimin, para. 33; Vendimi i Dhjetë për Paraburgimin, para. 53; Vendimi i Nëntë për Paraburgimin, para. 37; Vendimi i Tetë për Paraburgimin, para. 42; Vendimi i Shtatë për Paraburgimin, para. 43.

⁸² Vendimi i Shtatë për Paraburgimin, para. 43, që i referohet Vendimit të Parë të Apelit mbi Paraburgimin e Krasniqit, para. 69.

⁸³ Aktakuza e Konfirmuar, para. 10-12, 32, 39-40, 44, 49, 53, 55-57, 176-177.

⁸⁴ *Shih më lart*, para. 37-39.

(iv) çështja kundër z. Krasniqi është komplekse;⁸⁵ (v) ekziston atmosfera e frikësimit të dëshmitarëve e përshkruar më lart; dhe (vi) gjykimi vazhdon.

45. Sa i përket parashtrimit të Mbrojtjes së Krasniqit se modifikimet e fundit të kushteve në objektin e paraburgimit tashmë kanë pasur pasoja të konsiderueshme mbi të drejtat e z. Krasniqi dhe se këta faktorë janë relevantë për proporcionalitetin,⁸⁶ Trupi Gjykses rikujton se ky vendim ka të bëjë me lirimimin e përkohshëm ose paraburgimin dhe jo me kushtet e paraburgimit, ku i pari përfshihet në rregullën 57 dhe i dyti në rregullën 56(6).⁸⁷ Gjithashtu, Trupi Gjykses nuk është bindur se rrethanat që përshkruan Mbrojtja e Krasniqit lidhur me kufizimet e zbatuara për të paraburgosurit e tjerë⁸⁸ mund të ndikojnë materialisht në shqyrtimin e paraburgimit të z. Krasniqi.⁸⁹ Trupi Gjykses është bindur se ato masa janë të domosdoshme dhe proporcionale dhe në përputhje me të drejtat e z. Krasniqi⁹⁰ dhe se nuk e bëjnë të paarsyeshëm vazhdimin e paraburgimit të tij.⁹¹ Gjithashtu, Trupi Gjykses është bindur se mirëqenia dhe e drejta për jetë familjare e z. Krasniqi⁹² aktualisht respektohen si duhet në objektin e paraburgimit.

46. Duke pasur parasysh sa më lart, dhe sidomos faktorët e përmendur në paragrafin 44 më lart, Trupi Gjykses konstaton se paraburgimi i z. Krasniqi për dy muaj shtesë është i domosdoshëm dhe i arsyeshëm në rrethanat konkrete të çështjes.

47. Megjithatë, Trupi Gjykses vëren se z. Krasniqi është në paraburgim për një kohë të konsiderueshme dhe se gjykimi në këtë çështje ka mundësi të zgjasë. Siç

⁸⁵ *Shih p.sh.* Vendimi i Gjashtë për Paraburgimin, para. 59; F00978, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit*, 19 shtator 2022, konfidencial, para. 58 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 23 shtator 2022, F00978/RED); Vendimi i Katërt mbi Paraburgimin, para. 81.

⁸⁶ Përgjigjja, para. 14.

⁸⁷ *Shih gjithashtu* Vendimin e Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 46.

⁸⁸ *Shih* Përgjigjen, para. 14.

⁸⁹ *Shih gjithashtu* Vendimin e Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 46.

⁹⁰ *Shih gjithashtu* Vendimin e 1 Dhjetorit 2023, para. 29.

⁹¹ *Shih gjithashtu* Vendimin e Trembëdhjetë për Paraburgimin, para. 46.

⁹² Neni 36 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës; Neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

ka vënë në dukje Trupi Gjykses më parë,⁹³ kjo kërkon nga Trupi Gjykses, si dhe nga palët, që të kenë sidomos parasysh nevojën për të siguruar kryerjen sa më të shpejtë të gjykimit. Trupi Gjykses do të vazhdojë në çdo fazë të këtij procesi të monitorojë nëse vazhdimi i paraburgimit është i domosdoshëm dhe i arsyeshëm.

V. VENDIM

48. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit të z. Krasniqi; dhe
- b) **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë parashtrime në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Krasniqi deri të **mërkurën, 24 prill 2024 (ora 16:00)**, me parashtrimet përkatëse me shkrim sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

E premte, 15 mars 2024

Në Hagë, Holandë.

⁹³ *Shih p.sh.* Vendimin e Trembëdhjetë për Paraburgimin para. 49; Vendimin e Dymbëdhjetë për Paraburgimin, para. 49; Vendimin e Njëmbëdhjetë për Paraburgimin, para. 35; Vendimin e Dhjetë për Paraburgimin, para. 56; Vendimin e Nëntë për Paraburgimin, para. 39; Vendimin e Tetë për Paraburgimin, para. 44; Vendimin e Shtatë për Paraburgimin, para. 46.